



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.12.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Shqyrtimi i projektligjit "Për një shtesë në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar" *(nismë e deputetit E. Shalsi) (komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Lorenc Luka, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Irena Malolli – drejtoreshë e telekomunikacionit, Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës

Edlira Dvorani – anëtare e Këshillit Drejtues të AKEP-it

Altin Rrapaj – drejtor i Rregullimit të Tregut pranë AKEP-it

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Para se të fillojmë mbledhjen, a ka ndonjë koment në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Nuk ka.

Atëherë, miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Kalojmë te rendi i ditës së sotme!

Siç jeni njoftuar, sot kemi parashikuar shqyrtimin e projektligjit "Për një shtesë në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar". Kjo është një nismë imja, që vjen pas disa muajsh me diskutime dhe debate.

Për histori, që në mbledhjet e komisionit të zhvilluara në Kosovë, ne kemi konstatuar se ka hapësira për të rregulluar raportet midis dy vendeve në lidhje me shërbimin e telefonisë celulare, pikërisht për të reduktuar apo për të hequr tarifat e roamingut.

Kjo nuk është një iniciativë, që vjen papritur. Në fakt BE-ja prej shumë vitesh e ka bërë pjesë të diskutimeve dhe për pasojë sot, ka kaluar nga faza e reduktimit deri në heqjen e tarifave roaming.

Mbas takimit me grupin e deputetëve kosovarë, u njohëm me miratimin e një rezolute në Parlamentin e Kosovës në lidhje me heqjen e tarifave roaming. Që prej asaj periudhe kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me AKEP-in, përfaqësuesit e të cilit i kemi ftuar sot në komision. Janë të pranishëm sot zonja Edlira Dvorani, zoti Altin Rrapaj, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision.

Nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës kemi ftuar zonjën Irena Malolli, së cilës i uroj gjithashtu, mirëseardhjen në komision.

Që prej qershorit të vitit 2017, një european paguan për roaming-un të njëjtin çmim që paguan në vendin, ku ai është rezident.

Parlamenti European dhe Këshilli i Europës, kur bënë marrëveshjet roaming brenda BE-së, i kërkuar Komisionit European të ndërmerre disa masa mbështetëse për ta bërë këtë iniciativë funksionale. Sigurisht, debati është shoqëruar edhe me disa shqetësime për disa problematika të mundshme, të cilat mbasi janë bërë objekt diskutimi edhe me përfaqësuesit e ministrisë, edhe me ata të AKEP-it, mendojmë se janë të kapërcyeshme. Nga pikëpamja e

aplikimit në BE gjykohet se ka qenë një projekt i suksesshëm. Është rritur trafiku në lidhje me hyrjen në fuqi të heqjes së tarifave roaming në qershor 2017 dhe shumë konsumatorë europianë po shijojnë konektivitetin me kosto të ulët dhe me cilësi të lartë në vendet e BE-së.

Siç ju thashë, në datën 30 maj 2018 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar një rezolutë për heqjen e tarifave roaming, që parashikon se qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të integritetit ekonomik me RSH-në të nisë procedurat për heqjen e tarifave roaming ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Ndërkohë, ne gjykuam të kalojmë me një propozim konkret dhe ta miratojmë në Kuvend heqjen e tarifave roaming.

Siç thashë, sot kemi ftuar përfaqësuesit nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës dhe nga AKEP-i. Besoj se ky është një hap i rëndësishëm dhe konkret për të gjithë ne.

Me nenin 1 të projektligjit do të ndryshojmë nenin 55, pika 2 të ligjit aktual, të cilin po e citoj: “Në nenin 55, në pikën 2, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c" me përmbajtje si më poshtë: "c) shërbimet e roamingut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të dakordësuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime.”

Ndërkohë, ka edhe një propozim tjetër për një shtesë nga AKEP-i. Do të donim të dinim edhe opinionin e ministrisë për të. Projektligji është parashikuar për t’u diskutuar në seancë plenare më 13.12.2018.

Kjo është nisma e bërë. Do të sugjeroja t’u jepnim fjalën respektivisht përfaqësuesve të AKEP-it e atyre të ministrisë dhe më tej, të vijonim me pyetje, përgjigje, komente dhe sugjerime.

Jeni dakord me rendin?

Dakord.

Atëherë, fjalën e ka përfaqësuesja e AKEP-it!

Edlira Dvorani – Duke ju falënderuar për interesimin dhe për shtesën që po bëhet në këtë nismë, ne propozojmë dy saktësime: fjala “të dakordësuara” në pikën “c”, të zëvendësohet me “të nënshkruara dhe të miratuara”.

Ndërkohë, pika “c” e nenit 55, të shtohet në këtë formë: “Shërbimet e roamingut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe të nënshkruara ose të miratuara për zbatim reciprok të shërbimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit

ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime.” Pjesa e fundit është shtesa që ne propozojmë, nëse do të miratohet pas diskutimeve.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Dakord.

Do të ishte me interes edhe për kolegët, edhe për publikun që zoti Rrapaj të na shpjegojë më me detaje se çfarë impaktesh financiare ka për kompanitë respektive në Shqipëri dhe në Kosovë.

Së dyti, ne kemi kërkuar të jemi pjesë e një marrëveshjeje brenda të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor për reduktimin apo heqjen e tarifave roaming.

Një pyetje që na është bërë, është: a mund të ketë impakt kjo marrëveshje bilaterale në marrëveshjen rajonale?

Altin Rrapaj - Ju falënderoj, zoti kryetar i komisionit!

Në lidhje me impaktin financiar, dua t’ju sqaroj se heqja e tarifave roaming bëhet për përdoruesin fundor, pra për konsumatorët dhe bizneset, të cilët në përdorimin e shërbimeve celulare, kur bëjnë roaming ndërkombëtar në Kosovë apo në vendet e tjera me të cilat lidhin marrëveshjet dy ose shumëpalëshe, të paguajnë të njëjtën tarifë sikur të ishin në Shqipëri.

Ndërkohë, midis operatorëve do të vazhdojnë të aplikohen, ose do të vijojnë tarifa me shumicë që quhen *Wholesale Prices* dhe këto edhe me modelin e BE-së që ka zbatuar tarifimin e roamingut si në shtëpi, vijojnë të jenë, por me tarifa shumë të reduktuara për të mundësuar heqjen e tarifave për përdoruesin fundor.

Për sa i përket impaktit financiar, projektligji parashikon të drejtën e AKEP-it për të rregulluar tarifat e roamingut ndërkombëtar.

Për marrëveshjen 2-palëshe, që është lidhur tashmë me Kosovën, rezulton se Kosova është partneri kryesor i Shqipërisë për sa i përket shkëmbimit të trafikut dhe përdorimit si nga qytetarët e Shqipërisë, si ata të Kosovës.

Në terma financiare të ardhurat e 3 operatorëve celularë në vitin 2016-2017 kanë qenë rreth 250 mijë euro në vit për të ardhurat me shumicë, kur përdoruesit kosovarë vijnë në Shqipëri.

Ndërkohë, kur përdoruesit shqiptarë shkojnë në Kosovë, kostot e operatorëve celularë që u paguajnë operatorëve të Kosovës kanë qenë rreth 150 mijë euro në vit. Në termat kosto

neto dhe të ardhura neto, kjo do të thotë se operatorët shqiptarë përfitojnë rreth 100 mijë euro të ardhura neto me shumicë. Ky është një impakt.

Megjithatë, aktualisht operatorët e Kosovës dhe ata të Shqipërisë për sa u përket marrëdhënieve me shumicë dhe tarifave me shumicë, kanë tarifa shumë të reduktuara dhe planifikojnë skonto të rëndësishme gjatë sezoneve turistike. Rezulton se tarifat mesatare të aplikuar tashmë midis operatorëve në Shqipëri dhe në Kosovë me shumicë, janë të ngjashme me tarifat me shumicë që aplikohen në vendet e Bashkimit Europian. Në këtë mënyrë, edhe imponimi i rregullimit të këtyre tarifave, nëpërmjet marrëveshjes nga AKEP-i, nuk mendohet të ketë impakt në të ardhurat me shumicë të operatorëve apo në kostot me shumicë.

Ndërkohë, ajo që është shprehur është ose se do të ketë ndikim, heqja e *roaming*-ut për përdoruesit fundorë, *retail*-i (tarifat me pakicë), që mund të ketë një impakt rreth 200 mijë euro, që mendohet të jenë të ardhurat e operatorëve të telefonisë celulare nga *roaming*-u me pakicë i përdoruesve shqiptarë në Kosovë.

Gjithsesi, marrëveshja e lidhur parashikon që AKEP-i, në bashkëpunim me rregullatorin e Kosovës, të marrë masa për një reduktim të përshkallëzuar, në mënyrë që edhe të ruajnë interesat e operatorëve, edhe të maksimizojnë njëkohësisht interesat e përdoruesve shqiptarë. Siç e thashë, për shembull, përdorimi i madh nuk na rezulton të jetë *voice*-i apo thirrjet zanore celulare, por interneti. Kjo përbën bazën dhe aktualisht përdoruesit si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, kur bëjnë *roaming*, kanë tarifa tejet të reduktuara, sidomos gjatë sezonit turistik. Pra, impakti për të ardhurat e operatorëve mendohet të jetë përsëri minimal.

Për sa i përket impaktit më të gjerë në rastin e lidhjes së marrëveshjes rajonale ndërmjet gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, rezulton se Kosova, siç e thashë, është partneri kryesor dhe Shqipëria ka trafik tejet të reduktuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Pra, impakti kryesor mund të jetë vetëm me Kosovën.

Për sa u përket marrëveshjeve, qeveria ose Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka nënshkruar tashmë marrëveshjen me Ministrinë për Komunikimet Elektronike në Kosovë prej datës 26 dhjetor. Ndërkohë, marrëveshja rajonale është duke u diskutuar edhe me BEREC-un, edhe me Komisionin Europian, të cilët janë në faza negociatash. Është bërë edhe një takim dje në BEREC për këtë qëllim, ku merr pjesë edhe kryetari i AKEP-it. Megjithatë, çështja është edhe në

nivel politik. Për shembull, na rezulton se takimi i djeshëm është bojkotuar nga Serbia. Pra, nuk e dimë si do të ecë finalizimi i kësaj marrëveshjeje rajonale për shkak edhe të politikës rajonale.

Eduard Shalsi – E qartë.

Përfaqësuesja e ministrisë?

Irena Malolli – Faleminderit për ftesën dhe për nismën e ndërmarrë për të bërë një amendim në ligjin bazë “Për komunikimet elektronike”, duke parashikuar mundësinë e rregullimit të tarifave *roaming*, që mungon në legjislacionin aktual!

Nisma është në harmoni me të gjithë aktivitetin dhe me nismat që ka ndërmarrë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë gjatë këtij viti, si ministri përgjegjëse për politikën e zhvillimit të sektorit të komunikimit elektronik dhe legjislacionin përkatës.

Praktikisht, ndryshimi i ligjit për të mundësuar rregullimin e tarifave të *roaming*-ut është parë i nevojshëm jo vetëm së brendshmi, në diskutimet që ne kemi pasur si ministri dhe me rregullatorin, por edhe në ekspertizën që është dhënë në kuadër të analizës së impaktit të rregullimit të *roaming*-ut në rajon.

Ndryshimi i ardhur është në përputhje me angazhimet që janë marrë në Samitin e Triestes: me adoptimin e planit shumëvjeçar të krijimit të zonës ekonomike rajonale për *roaming free* dhe ndjekjen e modelit sipas rregullimit të *roaming*-ut në BE; me deklaratën e përbashkët të Samitit të Sofjes (të nënshkruar në maj të këtij viti), si dhe me të gjitha aktivitetet e tjera që ne jemi duke kryer. Praktikisht ne jemi në një proces, sikurse u përmend nga përfaqësuesi i AKEP-it, ka një marrëveshje të nënshkruar një javë më parë me ministrinë përgjegjëse të Kosovës, për të mundësuar heqjen e *roaming*-ut gradual ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, dhe njëkohësisht në një proces negocimi për të qenë pjesë e një marrëveshjeje të re rajonale për rregullimin e *roaming*-ut në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë proces janë angazhuar vetë Komisionerja e Bashkimit Europian për axhendën dixhitale, aktorët që veprojnë në këtë fushë në rajon apo edhe përfaqësuesit e të gjitha vendeve.

Në plotësim të këtij procesi, ministria bashkë me AKEP-in, duke filluar nga janari i këtij viti, ka qenë në një komunikim të vazhdueshëm me operatorët e telefonisë celulare për t’u shpjeguar atyre procesin dhe të gjitha hapat që po ndërmerren.

Pjesa e ndryshimit ligjor është njëri nga angazhimet që duhet plotësuar, në mënyrë që kjo gjë të bëhet efektive dhe të zbatohet.

Për sa i përket shtesës së propozuar nga AKEP-i në fund të germës “c” të nenit 55, ka dalë e nevojshme në diskutimet teknike që ne kemi pasur me operatorët, pasi, për të mos krijuar konfuzion, bëhet vetëm rregullimi i çmimit të pakicës dhe ai ka impakt negativ te çmimi i shumicës nëse nuk shkojnë në harmoni. Prandaj është e nevojshme të ketë një plotësim për të bërë qartësimin e këtij procesi rregullimi, në mënyrë që të ruajë vlerën e tarifës së *wholesale*-it në momentin kur rregullohet pjesa e tarifës së pakicës.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Pra, jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush ka pyetje? Po, zoti Marto.

Andrea Marto – Duke ju përgëzuar për nismën, unë kam dy shqetësime.

Së pari, a duhet të konsiderohet kjo marrëveshje dhe të marrë një miratim paraprak nga institucione të tilla, si: Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit ose institucione të tjera që mbulojnë fushën?

Së dyti, a është diskutuar paraprakisht me operatorët në Shqipëri dhe në Kosovë që ofrojnë shërbime?

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Po, zonja Malolli.

Irena Malolli – Për sa i përket nevojës së diskutimit në ITU, nuk është e nevojshme. Në nënshkrimin ose përgatitjen e draftit të marrëveshjes është respektuar ligji “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, drafti është qarkulluar dhe është diskutuar edhe me aktorët e interesuar, edhe me operatorët. Ne kemi startuar procesin e diskutimit të një marrëveshjeje të mundshme më të avancuar kundrejt asaj rajonale me Kosovën që nga korriku. Më 7 korrik është zhvilluar një takim i nivelit të lartë me përfaqësuesit e të tre operatorëve të telefonisë celulare, me bordin e AKEP-it, si dhe me përfaqësuesit e lartë të ministrisë për të diskutuar rreth këtyre zhvillimeve. Njëkohësisht, mbi bazën e atij takimi të parë të nivelit të lartë, u dakordësua që të ngrihet një grup teknik me përfaqësues të rregullatorit, të ministrisë dhe tre operatorëve të telefonisë celulare për të diskutuar për çështjet e *roaming*-ut, pra jo thjesht për të

reflektuar në këto procese vullnetin politik dhe interesin, sikurse u tha, që është më shumti te përdoruesi fundor, por për të gjetur zgjidhjet e duhura teknike. Madje pikërisht në nivel teknik diskutohen problematikat që kanë zbatimet e këtyre marrëveshjeve që janë me interes të rëndësishëm për publikun: reduktimin e tarifave *roaming*, mundësimin e lëvizjes së lirë jo vetëm për qytetarët, por edhe krijimin e një klime të favorshme për bizneset ndërmjet vendeve.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për ta sqaruar nga pikëpamja teknike, zoti Marto, me këtë ndryshim ne i hapim udhë, le të themi, AKEP-it që të hyjë në marrëveshje me rregullatorët për heqjen e *roaming*-ut.

Në rregull?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, që të mos ketë pengesa ligjore.

Atëherë, përfaqësuesit e ministrisë folën për nenin shtesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...apo do ta bëjmë shtesë të nenit të parë, nga pikëpamja...?

Irena Malolli – Jo, nuk është e nevojshme.

Është në rregull me çfarë është propozuar nga AKEP-i, sepse ruhet formulimi juaj dhe shtohen fjalët: “si dhe tarifat e terminimit ndërkombëtar”. Kjo, në mënyrë që ato të shkojnë në harmoni me *retail*-in.

Eduard Shalsi – Atëherë, e hedhim në votim në parim.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim nen për nen.

Neni 1, me propozimet e AKEP-it. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Duke ju falënderuar dhe duke ju uruar punë të mbarë, nuk na mbetet gjë tjetër veçse të urojmë që ta shohim heqjen e *roaming*-ut me Kosovën sa më shpejt të realizuar në praktikë!

(Deputeti Baraj flet pa mikrofon.)

Irena Malolli – Urdhëroni?

Eduard Shalsi – Sa kohë mund të duhet, pyet zoti Baraj, që marrëveshja të bëhet efektive?

Irena Malolli – Atëherë, duke qenë se për të dyja vendet mund të ishte i nevojshëm ndryshimi ligjor, marrëveshja e nënshkruar ka lënë një hapësirë kohore deri në fund të marsit të vitit tjetër që ndryshimet ligjore të hyjnë në fuqi...

Eduard Shalsi – Në rregull.

Irena Malolli – ...sepse ne ishim më të avancuar, por e njëjta gjë duhej edhe nga pala e Kosovës. Njëkohësisht, duhen bërë edhe përgatitjet konkrete teknike nga ana e operatorëve dhe vendimmarrja e rregullatorit. Është menduar që zbatimi i marrëveshjes të fillojë nga data 15 qershor e vitit tjetër.

Eduard Shalsi – Atëherë, urojmë që sezoni turistik i vitit që vjen të jetë pa *roaming* për qytetarët e të dyja shteteve.

Në rregull.

Duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrjen, shihemi në mbledhjen e ardhshme të komisionit!

MBYLLET MBLEDHJA